

KONTRATË PËR TRANSFERIM KUOTASH PA KUNDËRSHPËRBLIM

Sot më datë 14/12/2023, bazuar në nenet 73 e në vijim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar nënshkruhet kjo Kontratë për Transferim Kuotash pa Kundërshpërblim ("Kontrata") ndërmjet Palëve të mëposhtme:

Neni 1 Palët Kontraktuese

- A. Shoqëria "Le Spot Group" SHA, me NUIS K914130130, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "Spot Communications" SHPK me ortak te vetem zj. Mirza Alibegaj, përfaqësuar nga Administratori Vilma Maze nga këtu e më poshtë referuar si "**Dhuruesi**"

dhe

- B. Zefina Asani, shtetase Shqipëtare, e lindur në Laç, Shqipëri, e datëlindjes 16.01.1974, e identifikuar nga Letërnjoftimi me Nr. Personal H45116152A, madhore me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, nga këtu e më poshtë referuar si "**Pranuesi i Dhurimit**".

Neni 2 Objekti i Kontratës

- 2.1. Objekti i kësaj kontrate, është dhurimi prej Dhuruesit kundrejt Pranuesit të Dhurimit e një pjese të kapitalit që shoqëria Le Spot Group SHA zotëron në shoqërinë "Spot Communications" SHPK, e konkretisht:
- a. Dhurimi i 2 % te kuotave qe Shoqeria "Le Spot Group" SHA ka ne cilesine e ortakut te Shoqerise "Spot Communications" SHPK, kundrejt zj. Zefina Asani, me vlerë 6,000 ALL (gjashtë mijë leke);

Neni 3 Transferimi i kuotave pa kundërshpërblim

- 3.1. Dhuruesi shpreh vullnetin e lirë për transferimin pa kundërshpërblim (dhurimin) tek Pranuesi i Dhurimit.
- 3.2. Pranuesi i Dhurimit shpreh vullnetin e tij për pranimin e kuotave nëpërmjet dhurimit.
- 3.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Ortakë të shoqërisë "Spot Communications" SHPK, do të jenë:
- a. Shoqëria "LE SPOT GROUP" SHA, zotëruese e 96 % te kuotave te shoqerise me vlerë nominative prej 288.000 Lekë;
- b. Zj. Selena Kurti, zotëruese e 2% te kuotave te shoqerise vlerë nominative prej 6,000 Lekë;
- c. Zj. Zefina Asani, zotëruese e 2% te kuotave te shoqerise vlerë nominative prej 6,000 Lekë;

Neni 4
Garanci të Dhuruesit

- 4.1. Dhuruesi garanton se kuota (kapitali) objekt dhurimi i kësaj kontrate, nuk është lënë peng, në dorëzani apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi të.
- 4.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi atë pjesë të kapitalit që është objekt Dhurimi sipas kësaj kontrate, kapital që menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon në raportet e cituara në nenin 2 të kësaj kontrate.

Neni 5
Garanci të Pranuesit të Dhurimit

- 5.1. Pranuesi i Dhurimit pas nënshkrimit të kësaj kontrate ka të drejtë për të përfituar çdo dividend të mundshëm, si rezultat i kapitalit që ata do të zotërojnë në shoqëri, por nuk do të ketë të drejtë të marre pjesë në procese të tjera vendimmarrje brenda shoqërisë deri në 31 Dhjetor të vitit 2029. Në çdo rast, Pranuesi i Dhurimit do të jetë përfitues të dividendit vetëm në ato raste kur asambleja e ortakëve në përputhje me dispozitat e ligjit, merr vendim për shpërndarje dividendi.
- 5.2. Nëse Pranuesi i Dhurimit vendos të tjetërsojë kuotat e përfituara sipas kësaj kontrate, tek palet e treta, ai do të jete i detyruar të respektojë fillimisht të drejtën e parablerjes nga Ortaku Maxhoritar Shoqëria “Le Spot Group” SHA. Pranuesi i Dhurimit gjithashtu nuk ka të drejtë të vendosi barrë apo hipotekë mbi kuotat e tij pa miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 6
Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

- 6.1. Kjo kontratë përgatitet në 2 kopje, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.
- 6.2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

DHURUES

Shoqëria “LE SPOT GROUP” SHA

Vilma MAZE



Le Spot Group SH.A

NUIS: K 91413013 O

PRANUES I DHURIMIT

Zefina ASANI

